



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
BORDI

Nr. 196 prot
13

Tiranë më 01/07 / 2025

PROCESVERBAL

MBLEDHJE BORDI
(Datë, 25/06/2025)

Të pranishëm nga Bordi: Z.Vasil Tole, Z.Mentor Beqa, Znj.Alma Mirakaj, Znj.Etleva Smaçi, Z.Simon Mirakaj, Z.Niuton Mulleti, Znj.Laureta Roshi.

Rendi i ditës:

1. Përzgjedhja e anëtarëve të Këshillit Shkencor
2. Miratimi i ndryshimeve në rregulloren e funksionimit të Bordit
3. Shqyrtimi i ankimit të z. Agim Baçi për procesin e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të ISKK.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Bordit z. Mentor Beqa

M.Beqa: Përshëndetje, Fillojmë me pikën e parë të mbledhjes që është zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Shkencor. Janë 9 kandidatë nga të cilët do të përzgjedhim 6 sipas shpalljes që kemi bërë. Të gjithë janë personalitetë në fushat e tyre, dhe të gjithë janë Doktor Shkencash.

Lexohen emra e secilit kandidat, të cilët kanë aplikuar për anëtarë të Këshillit Shkencor.

V.Tole: Unë propozoj që të ruhet një balancë midis kërkuesve shkencorë dhe kërkueseve shkencore.

E.Smaçi: Unë dakort jam, por dua të jenë ekspertë të fushës, pasi mund të jenë historiane, por nëse nuk kanë asnjë artikull për periudhën e komunizmit, nuk ka kuptim të jenë pjesë e Këshillit.

L.Roshi: Unë nuk jam dakort, dua të votohen sipas kontributit të tyre.

M.Beqa: Mendoj ta bëjmë me votim preferencial, ku secili nga anëtarët të votojë për 6 kandidatë dhe mbledhim votat për secilin kandidat.

Të gjithë anëtarët janë dakort me mënyrën se si do të votohet dhe formatin e fletës ku do të votohet. Printohet fleta e votimit me emrat e 9 kandidatëve dhe iu shpërndahen secilit anëtar të Bordit. Pas votimit nga secili anëtar, fletët mblidhen te kryetari i Bordit z.Mentor dhe

fillojnë me numërimin e votave për secilin kandidat. Anëtari i Bordit Z.Vasil lexon fletën e votimit, Kryetari i Bordit mban shënim për secilin kandidat se sa vota ka marrë.

Në përfundim të numërimit, Kryetari i Bordit lexoi votat e mbledhura për secilin kandidat.

M.Beqa: Votat që secili kandidat ka marrë janë si vijon:

Ines Stasa 7 vota

Ardian Muhaj 6 vota

Edlir Orhani 6 vota

Enriketa Pandelejmoni 6 vota

Gentiana Kera 5 vota

Vehap Kola 4 vota

Florencia Stafa 3 vota

Hasan Bello 3 vota

Indrit Idrizi 2 vota

Nga ky rezultat, 6 emrat e parë janë emrat e rindë të Këshillit Shkencor.

Pasi të lajmërohen që janë përzgjedhur, t'i kërkohet anëtarëve të bëjnë mbledhjen e parë të konstituimit.

Vazhdojmë me pikën e dytë të mbledhjes e cila kishte të bënte me rregulloren e Bordit. Mendoj se kemi nevojë për më shumë kohë, ndaj propozoj nëse jeni dakord, për ta zhvilluar një mbledhje tjetër ndoshta nga shtatori?

E.Smaçi: Dakort

L.Roshi: Dakort

S.Mirakaj: Dakort

V.Tole: Dakort

N.Mulleti: Dakort

A.Mirakaj: Dakort

M.Beqa: Të diskutojmë edhe për një mbledhje e cila është për miratimin e kolanës së librave për botim për vitin 2025. Propozoj për datën 11 korrik, ora 9:00.

Të gjithë anëtarët ranë dakort për zhvillimin e mbledhjes së ardhshme.

V.Tole: Unë mendoj që librat të rishikohen edhe njëherë nga Këshilli Shkencor i sapozgjedhur sa për të qënë në dijeni. Rekomandimi i tyre është këshillues.

M.Beqa: Librat janë shqyrtuar nga Këshilli Shkencor dhe ata kanë bërë vlerësimet për librat dhe relacionin përkatës. Por megjithatë, në mbledhjen e parë, t'i dërgohen librat edhe këtij Këshilli për t'i parë dhe ata të na dërgojnë mendimin e tyre.

N.Mulleti: Kam një propozim për mbledhjen e ardhshme nëse mund të diskutojmë për Spaçin, për një qëndrim që ne mund të kemi si Bord.

V.Tole: Ne duhet t'i qëndrojmë idesë së ISKK që thotë se Spaçi duhet të trajtohet si monument kulture. Ka një qëndrim të ISKK më parë dhe mendoj t'i qëndrojmë atij qëndrimi. Të dërgohet një shkresë me qëndrimin tonë që Spaçi të trajtohet me statusin muzeor. Shkresa t'i dërgohet Ministrisë së Kulturës apo edhe institucioneve të tjera që merren me këtë çështje.

M.Beqa: Jeni dakort me këtë propozim?

S.Mirakaj: Jam dakort që asgjë mos të ndryshojë në atë kamp.

Të gjithë anëtarët e Bordit bien dakort me propozimin. Kryetari i Bordit do të shkruajë letër dhe do t'u dërgohet instancave përkatëse.

M.Beqa: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës për shqyrtimin e ankimit të z. Agim Baçi për procesin e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të ISKK. Jeni dakort më menyrën se si do të vazhdojmë duke pyetur personat që ne kemi thirrur. Unë jam dakort që pasi të dëgjojmë palët që ne kemi thirrur, të vazhdojmë me diskutimet.

V.Tole: Nëse ai fakt qëndron, duhet pyetur ankimusë, personi i prekur edhe një shkresë nga personeli i ISKK. Nëse ai pretendim është i vërtetë, ne duhet t'i drejtohem Komisionit të Ligjeve për këtë situatë për një intepretim të qartë.

N.Mulleti: Mendoj të dëgjojmë palët si fillim, pastaj të diskutojmë.

S.Mirakaj: Nëse na vjen një pretendim me një diplomë të marrë nga një shkollë ushtarake, i japim të drejtë ankimusit, nëse jo, këto pretendime që ka, bien poshtë.

M.Beqa: Të thirret ankimusë.

Thirret ankimusë z. Agim Baçi për të marrë pjesë në mbledhje.

M.Beqa: Ju kemi ftuar për të parashtruar pretendimet e drejtuara me shkresë zyrtare Bordit të ISKK, ku pretendoni se kandidati fitues nga votimi i Bordit nuk duhej të merrte pjesë në këtë garë. Brenda një kohe të arsyeshme, mund të na thoni pretendimet tuaja?

A.Baçi: Unë erdha për respekt të Bordit. Për procesin e zgjedhjes, nuk kam diçka kundër, por i kam shkruar në shkresë pretendimet e mia.

M.Beqa: Nuk doni të bëni një parashtrim për çfarë keni shkruar? Nëse jo, Bordi mund të vazhdojë me pyetje nëse ka.

A.Baçi: Unë mendoj se ajo çështje është ligjore. Nuk e shikoj si diçka midis meje dhe jush. Për mua, ky institucion është i rëndësishëm, pasi nëse nuk do ta kisha parë kështu, do ta kisha bërë bisedë publike. Unë dua një përgjigje nga ju për atë që unë kam parashtruar, jua solla herën e parë, jua solla përsëri sot me email, sepse kjo është e rëndësishme për mua dhe për këtë institucion.

M.Beqa: Z. Agim nuk ka më gjë për të shtuar nga ato çfarë ka thënë në letrën zyrtare. Ne ju kemi thirrur këtu për gjithëpërfshirje z. Baçi për të qënë të paanshëm me të gjitha palët dhe në fund, do të dalim me një mendim, ku ju do të njoftoheni. Vazhdojmë me pyetjet nëse ka?

L.Roshi: Ju keni shkruar këtu se ligji ka qënë i qartë për sankzionet e vendosura në këtë rast? Konkrektisht çfarë doni të thoni ?

A.Baçi: Për nenin 18 e kam thënë .Jam konsultuar me jurist, kur i jam drejtar Bordit. Eshte shume e rëndë të fshihet e verteta.Unë jam gazetar po spo e bej publike pa e diskutuar me ju.

L.Roshi: Ai ka qënë në rikandidim,dhe nuk e ka shkruar serish këtë të dhënë qe ju na e paraqisni me dokument.

A.Baçi: Me atë çështje merreni ju. Unë flas për tanë për më parë nuk e di çfarë ka ndodhur.

V.Tole: Keni vrejtje për procedurën e zgjedhjes së drejtorit?

A.Baçi: Unë nuk jam marrë me procedurën por vetëm me nenin 18 të ligjit të ISKK.

E.Smaçi: Bordi është vënë në një situate jo normale, pasi ka marrë një ankesë që nuk lidhet me procedure por përzgjedhjen e kandidatëve pa u interpretuar juridikisht nëse ata plotësonin

kriteret e garës. Burimet njerëzore duhet të kërkonin nga kandidatët të vetëdeklaroheshin nëse plotësonin kriteret e ligjet, duke përfshirë edhe nenin 18. Nëse ato kanë konstatuar një fakt të tillë dosja nuk duhet të kishte hyrë në konkurrim. Burimet njerëzore duhet ta kishin penguar këto gjëra që në fillim. Secili nga kandidatët i mban vet përgjegjësitë.

A.Baçi: Unë konfliktet nuk i shikoj si personale, emri im është shumë i rëndësishëm. Unë e kam kursyer ISKK pasi nuk e kam bërë publike këtë çështje, pa u drejtuar njëherë te ju, edhe pse i kam mundësitet.

S.Mirakaj: Unë kam ligjin këtu dhe po e citoj neni 18 të ligjit të ISKK (*citon nenin 18 të ligjit të Iskk*)

Sipas ligjit, ligji thotë nëse është shkolluar, pra nqs ka diplomë për këto shkolla, pra është e qartë që ska diplomë.

Në ankesë ju thoni se kandidati e mban të fshehtë këtë fakt, ju si e morët vesh këtë fakt?

A. Baçi: Unë e kam marrë vesh kur e keni marrë vesh dhe ju, edhe Kuvendi. Jam gazetar kam 30 vite, dhe kur ju është nisur ju ky informacion më është nisur dhe mua.

S.Mirakaj: Sepse z.Hoxha thotë se në kofidencën që ka pas me ju, ju ka thënë edhe këtë fakt ngajeta e tij.

N.Mulleti: Në lidhje me këtë informacion për z.Çelo, cili ka qënë burimi dhe dini cila ka qënë arsyaja e largimit nga shkolla?

A.Baçi: Këtë informacion kur ma ja kan nisur Bordit ,Kuvendit, ma kanë nisur edhe mua. Unë në fillim nuk u mora fare me këtë gjë. Kur e shpërfillët këtë gjë, u drejtova juve për intepretim dhe ju e dini që mund edhe ta kisha bërë publike si informacion pasi skam asnje pengesë për ta bërë këtë gjë.

N.Mulleti: E përsëritët disa herë këtë çështjen për ta bërë publik këtë informacion. Për mua personalisht, nuk ka asnje problem, edhe nëse e bëni publik.

A.Baçi: Unë ju drejtova juve, pasi ky është një informacion që e ka dhe Kuvendi, por është diçka që është në kompetencën tuaj që ju do ta vendosni.

L.Roshi: Ju prisni një përgjigje zyrtare nga Bordi?

A.Baçi: Po

M.Beqa: Ka më pyetje nga anëtarët e tjerë? Jo. Faleminderit z.Baçi. Të thirret z.Hoxha.

Thirret Z.Çelo Hoxha në ambientet e mbledhjes

M.Beqa: E dini akesën që është drejtuar për ju? Është ankesë se ju nuk përbushni kriterin për të qënë Drejtor i ISKK për shkak se ju keni kryer një vit shkollë në shkollën ushtarake “Skënderbej”.

Ç.Hoxha: Po, jam në dijeni të ankesës, por nuk është se shkresa më është dhënë zyrtarisht, ndaj kërkoj që të më vihet në dispozicion një kopje.

Ligjvënësi e ka parë të arsyeshme që në ISKK të mos depërtojnë njerëz që kanë qenë në konflikt interes i me të shkuarën komuniste.

Unë jam dërguar në Shkollën e Bashkuar për disa muaj, pastaj jam larguar si i paaftë për të kryer këtë shkollë.

M.Beqa: Meqë e pranoni që fakti ekziston, a e keni detyrim ligjor për të deklaruar këtë fakt para kandidimit, pasi ka pretendim për fshekje informacioni?

Ç.Hoxha: Detyrimi është për të deklaruar shkollimin dhe kualifikimin sipas ligjit.

M.Beqa: Z.Hoxha e pranoi faktin që ka qënë në këtë shkollë, por ky fakt nuk përbën detyrim ligjor për ta deklaruar. Këto janë dy elemente shumë të rëndësishëm.

Pse mendoni se nuk përbën shkelje ky fakt për të kandiduar për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv?

Ç.Hoxha: Sepse përkufizimi i ligjit parashikon shkollim, kualifikim apo procese të përmbyllura, të cilat janë të çertifikuara me dokument ligjor. Shkojmë te ligjet e arsimit të lartë se çfarë është shkollimi. (Citon disa nene të ligjit të arsimit të lartë të vitit 2015)

N.Mulleti: Te përkufizimi i ligjit të arsimit të lartë, koncepti i shkollimit është edhe më i gjerë.

Ç.Hoxha: Këtu është një sqarim më i detajuar që unë kam përgatitur të cilën po e dorëzoj në protokoll dhe t'ju dërgohet me email, si dhe dokumentin e largimit nga kjo shkollë.

V.Tole: Ka një statistikë se sa të persekutuar shkonin në këtë shkollë në periudhën e komunizmit?

Ç.Hoxha: Nuk e di në dijeninë time.

E.Smaçi: Z.Hoxha do të desha mendimin tuaj si do ta trajtonit ju një rast të tillë, nëse ju do të konstatonit një shkelje të tillë nga një konkurrent tjetër në garë?

Ç.Hoxha: Unë nuk bie në këto nivele. Mua më çuan në atë shkollë si ndodhët në ato vite.

M.Beqa: A ka më pyetje për diskutimin për të cilin është ftuar z.Hoxha? Faleminderit z.Hoxha. Të thirret znj.Zoica Graçi.

Thirret znj.Graçi në ambientit e mbledhjes.

M.Beqa: Prezantohuni për pozicionin e punës që ju mbani në ISKK.

Znj.Zoica Graçi prezanton veten si Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të ISKK, duke folur për shkollimin dhe punën në Institut.

M.Beqa: E dini për çfarë jeni thirrur në mbledhje?

Z.Graçi: Po.

M.Beqa: Cila ka qënë përgjegjësia juaj në përzgjedhjen paraparake të kandidatëve?

Z.Graçi: Sipas rregullores së Bordit, detyra jonë ka qënë të bëjmë verifikimin paraprak të dosjeve.

M.Beqa: Ju si njësi përgjegjëse e keni bërë verifikimin paraprak të dokumentacionit dhe na keni përcjellë neve ato kandidatura që plotësonin kriteret?

Z.Graçi: Po e kemi bërë dhe i kemi kaluar kandidaturat që plotësonin kriteret.

M.Beqa: Në rastin e kandidatit z.Hoxha, ka një pretendim për shkollimin e tij. Nëse ky fakt përbën shkelje, pasi nëse përbën shkelje, ju nuk duhet të na e sillnit neve si kandidaturë.

Z.Graçi: Unë jam vënë në dijeni për atë email para se të ndodhë procedura e zgjedhjes së drejtorit. Por në momentin që ky dokument për këtë vit shkollimi nuk ishte në dosje, nuk më takon mua t'ju vendos në dijeni.

M.Beqa: Pra, ju nuk keni qenë në dijeni formalisht për këtë çështje, prandaj nuk e keni njoftuar Bordin? Kjo është deklarata juaj apo keni një deklaratë tjetër?

Z.Graçi: Kjo është deklarata ime.

M.Beqa: A ka ndonjë kriter ligjor që e detyron Drejtorin për ta deklaruar këtë fakt?

Z.Graçi: Ne jemi të gjithë që duhet të bëjmë deklarimin për pastërtinë e figurës, meqë jemi persona publikë.

M.Beqa: A ka një model që ju e keni që e ka detyrim ta plotësojë kandidati që i është kërkuar ta plotësojë?

Z.Graçi: Jo, nuk ka një model.

V.Tole: Sa punonjës ka të ISKK që vijnë nga Shkolla e Bashkuar?

Z.Graçi: Jo, nuk ka.

E.Smaçi: A keni bashkëpunuar me një jurist në verifikimin e dosjeve meqë formimi juaj është në fushën financiare?

Z.Graçi: Si drejtore drejtorie eksperiencia na ka bërë që të njohim gjithë ligjet e administratës dhe mendoj se në këtë rast, nuk kishte diçka për t'u konsultuar me jurist.

E.Smaçi: Mendoj se kishte nevoje për konsultim me jurist, pasi nëse ne do të kishim një intepretim ligjor me shkrim se çfarë nënkoponon “shkollimi” diplomimin apo dhe një periudhë kohore të caktuar, si në rastin e zotit Hoxha, kjo çështje do të ishte zgjidhur që në fazën e konkurrimit dhe nuk do të ishim sot duke diskutuar.

N.Mulleti: Cili është mekanizmi që keni për të kontrolluar punonjësit për efekti të këtij ligji?

Z.Graçi: Jo, nuk kemi një mekanizëm, janë vetëm vërtetimet që lëshon AIDSSH.

M.Beqa: Faleminderit.

(Znj. Graçi largohet nga mbledhja)

Pasi dëgjuam palët, jemi para disa faktave.

Fakti i pretenduar nga Z. Baçi qëndron.

Kemi përcaktuar se ka opinione të ndryshme nëse ky fakt është skualifikues si fakt.

Jemi edhe në kushtet pasi ne e kemi zgjedhur Drejtorin Ekzekutiv.

Ne duhet të vendosim nëse duhet të pranojmë pretendimet e ankimuesit apo duhet t'i refuzojmë ato. Ne nga gjithë arsyetimi që kemi mbi ligjin duhet të dimë nëse ky fakt përbën arsyë për shkak për skualifikim për zgjedhjen si drejtues të këtij institucioni? Po e hap diskutimin që secili të japë mendimin e tij.

V.Tole: Duhet të themi edhe një fakt që ky vit shkolle nuk është përmendur në dokumentacion.

Unë mendoj se duhet t'i drejtohemi Kuvendit për interpretim. Pasi të marrim këtë mendim nga Kuvendi, ta diskutojmë se si do të veprojmë sipas përgjigjes që do marrim prej tyre.

E.Smaçi: Edhe unë këtë do kërkoja, pasi unë nuk dua të marr përgjegjësi, pasi nuk jam jurist që të intepretoj këtë ligj.

T'i drejtohemi Kuvendit për një mendim juridik, nga hartuesit e këtij ligji.

A.Mirakaj: Jemi para faktit që i dëgjuam palët. Kjo çështje mendoj se duhet të zgjidhet në gjykatë nga palët.

S.Mirakaj: Për mua, pretendimet e z.Agim bien poshtë, pasi unë kam ligjin këtu. Nëse do kishte një diplomë, do kishte të drejtë, kur nuk ka një diplomë, pretendimet e tij bien.

N.Mulleti: Unë jam i qartë që nuk ka kriter skualifikues që mund të aplikohet nga ana e Bordit. Anëtarët e Bordit kanë diskrecionin për të bërë intepretimin e ligjit. Për mendimin tim, përkufizimi “shkollim” është i qartë. E gjykoj të panevojshme t'i kërkohet ekspertizë një organi tjetër.

L.Roshi: Unë mendoj t'i drejtohemi Kuvendit për këtë termin “shkollim”.

M.Beqa: Në bindjen time, Kuvendi nuk intepreton ligje, Kuvendi prodhon ligje. Intepretimi i ligjit bëhet në gjykatë. Çdo intepretim që mund të vijë nga Kuvendi është informal dhe nuk përbën detyrim ligjor. Kush mund ta bëjë intepretimin ligjor për ne nga ana proceduriale? Unë nuk shoh mënyrën ligjore se si Kuvendi të na tregojeë ne si duhet të intepretojmë një

ligj, kur ne jemi autoriteti ligjor i zgjedhur prej tyre për të përbashkët detyrimet ligjore të miratuar nga Kuvendi. Unë nuk gjej dot arsyetim për t'i drejtuar Kuvendit.

N.Mulleti: I vetmi interpretim që mund të kemi ne është relacioni i ligjit të krijimit të ISKK kur ka shkuar në seancë plenare dhe përsëri, jemi ne që duhet të marrim vendimin.

M.Beqa: Opsioni i dytë është që Bordi të shprehë se ka shqyrtuar pozicionin e të gjitha palëve dhe vendos që nuk ka arsyë të mjaftueshme për të anulluar procesin e përzgjedhjes së drejtorit të institutit. Nëse ne bëjmë këtë, hapim dyert që procesi të shkojë aty ku interpretohet ligji, në gjykatë.

V.Tole: Unë në çdo rast do t'i drejtohem Kuvendit, edhe nëse ju e hidhni në votë. Do t'i drejtohem duke i shpjegur të gjithë procedurën e zgjedhjes, të gjithë historikun, duke i shpjeguar se nuk e interpretojmë dot çështjen e shkollimit. Edhe nëse nuk kthejnë përgjigje, ne e kemi bërë detyrën tonë.

M.Beqa: Nëse nuk vjen përgjigje, çfarë do bëjmë?

V.Tole: Nëse nuk vjen përgjigja, ne do mblidhemi si Bord dhe do shprehemi me votë.

E.Smaçi: Unë kérkoj që të mblidhemi përsëri këto ditë, pasi unë do të konsultohem edhe vetë me një jurist për këtë çështjen e shkollimit, pasi unë sot kam dëgjuar nga z.Hoxha që ky fakt është i vërtetë.

M.Beqa: Secili prej nesh mund të shprehë vullnetin individualisht.

V.Tole: Më mirë mos e ço në votim këtë sepse do drejtosh për 5 vite me 4 vota.

M.Beqa: A po bën shantazh me këto fjalë?

V.Tole: Jo, nuk bëj shantazh, por nuk do na kesh në krahë.

M.Beqa: Ta çojmë çështjen në votim.

V.Tole: Ne si Bord duhet të dalim me të njëjtën bindje dhe të mos ndahemi.

E.Smaçi: Organe të tillë duhet të respektojnë qasjen e çdo individi.

L.Roshi: Unë them të çohen të dy propozimet në rrjedhën e tyre, pa u vendosur të zgjedhim njëren prej tyre, t'i çohet shkresë Kuvendit.

V.Tole: Po jemi 3 vota që kemi këtë mendim.

M.Beqa: Po mendimi i 4 anëtarëve të tjerë?

N.Mulleti: Unë nuk kam asnjë lloj dyshimi, por siç u shpreha dhe më parë, mund të kérkojmë relacionin e ligjit nga Kuvendi.

V.Tole: Unë kam një propozim tjetër, ju mund të shpreheni me votë, por ne nuk na pengon askush që ti drejtohemi Kuvendit.

Pas këtyre diskutimeve ku nuk u ra dakort për një mendim të përbashkët. Anëtari I Bordit z.Vasil Tole u larguan nga mbledhja.

Zonja Smaçi u largua pasi u kërkua votim për një çështje ku ajo kishte paqartësi ligjore. Anëtarët vazhduan diskutimet nëse do ti kthenin përgjigjen gjatë kësaj mbledhje z.Baçi apo do ta shtynin për mbledhjen tjetër.

L.Roshi: Z.Çelo u zgjodh drejtor, tanë na doli një fakt që ai ka fshehur diçka që po ta kishte shkruar sic e theksoi dhe zonja Graci është kriter skualifikues. Mendoj se zoti Hoxha e ka fshehur me vetëdije nuk është treguar i sinqertë.

M.Beqa: Z.Çelo deklaroj se nuk e kishte detyrim për deklarim, por nuk e ka fshehur.

L.Roshi: Unë them t'i japim një përgjigje të përgjithshme z.Baçi dhe mbledhjen tjetër të jemi më të qartë.

M.Beqa: Thjesht do shtyjmë kohën se nuk kemi çfarë zgjidhim më.

N.Mulleti: Unë vetë jam i qartë dhe s'kam nevojë për mendime të tjera.

M.Beqa: Pas diskutimeve, unë propozoj të dalim me vendim në mbledhjen e sotme

Nënkryetaria e Bordit znj. L.Roshi u largua nga mbledhja pa u mbyllur mbledhja duke i kujtuar kryetarit se shkoi shumë gjatë diskutimi dhe se do ti drejtohej Kuvendit për sqarim.

Pas diskutimeve Bordi mori vendim me votat e anëtarëve në mbledhje, pra 4 anëtar Bordi që pretendimet e ngritura nga z. Agim Baçi në ankimin e tij të paraqitur nëpërmjet ankesës së protokolluar me Nr.186 Prot, datë 05.06.2025, në lidhje me mospërmbushjen nga ana e z. Çelo Hoxha të kriterit të veçantë të përcaktuar në germën b), së pikës 1 së Nenit 18, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar, janë të pabazuara në ligj dhe vendosi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ISKK-së Nr.5, datë 03.06.2025 dhe rrëzimin e ankimit në fjalë.

Gjithashtu u vendos ti kthehet një përgjigje z.Baçi duke u bazuar në vendimin e marrë nga Bordi si dhe ngarkua Sekretari i Bordit për njoftimin e ankuesit z.Agim Baçi në lidhje me këtë vendimmarrje.

Mbledhja deklarohet e mbyllur nga Kryetari i Bordit.

Mentor Beqa.....

Simon Mirakaj.....

Vasil Tole.....

Etleva Smaçi.....

Loreta Roshi.....

Alma Mirakaj.....

Niuton Mulleti.....

Mbajti Provesverbalin: Liljana Aliko

